

**VENDIM**  
**Nr. 35, datë 27.1.2021**

**PËR PLANIN VJETOR TË PRANIMIT, PËR VITIN 2021, NË INSTITUCIONET E  
ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PJESË TË SHËRBIMIT CIVIL**

*(ndryshuar me VKM-në nr. 731, datë 3.12.2021)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Numri i vendeve vakante të planifikuara për rekrutim gjatë vitit 2021 është, gjithsej, 889 (tetëqind e tetëdhjetë e nëntë), të ndara sipas kategorive të mëposhtme:

- |                                                               |      |
|---------------------------------------------------------------|------|
| a) për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues | 8;   |
| b) për kategorinë e mesme drejtuese                           | 60;  |
| c) për kategorinë e ulët drejtuese                            | 169; |
| ç) për kategorinë ekzekutive                                  | 652. |

2. Grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm në kategorinë ekzekutive janë, si më poshtë vijon:

- Shkenca juridike;
- Audit i brendshëm;
- Shkenca ekonomike;
- Shkenca ekonomike/juridike;
- Shkenca shoqërore;
- Shkenca sociale;
- Histori-filologji;
- Shkenca mjekësore;
- Veterinari;
- Agronomi;
- Shkenca biologjike dhe të ngjashme me to;
- Kimi;
- Shkenca mjedisore ose të tjera të përshtatshme;
- Shkenca inxhinierike;
- Arkitekturë;
- Arkeologji dhe restaurime;
- Arte të bukura;
- Gjeodezi;
- Shkenca ekzakthe;
- Shkenca edukimi;
- Mësuesi;
- Arsimit i lartë ushtarak/policor;
- Arsimit i lartë.

3. Institucionet e administratës shtetërore, ku planifikohen vendet vakante gjatë vitit 2021, janë sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR**  
**Edi Rama**

**LISTA E INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE KU  
PLANIFIKOHEN VENDET VAKANTE GJATË VITIT 2021**

1. Kryeministria dhe institucionet e saj të varësisë;
2. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;
3. Sistemi i Ministrisë së Brendshme;
4. Ministria e Mbrojtjes;
5. Sistemi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
6. Sistemi i Ministrisë së Drejtësisë;
7. Sistemi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
8. Sistemi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
9. Sistemi i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
10. Sistemi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
11. Sistemi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
12. Ministria e Kulturës.